



DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

10 Nr. 640-23563/21  
Klinë, 21.07.2021

**KONKURS LETRAR**

Për çmimin tradicional vjetor „ORA E TAHIR DESKUT” për veprën më të mirë letrare të botuar në mes dy manifestimeve letrare „ORA E TAHIR DESKUT” i cili mbahet tradicionalisht më 6 shtator.

**Kushtet për konkurrim:**

Të drejtë pjesëmarrje kanë krijuesit letrarë nga e gjithë hapësira shqiptare.

Konkurrimi fillon nga data e shpalljes në mjetet e informimit prej 21 korrik deri më 20 gusht 2021.

- Konkurrimi bëhet përmes nominimeve të institucioneve, shoqatave e asociacioneve letrare të regjistruara në Kosovë dhe individualisht.

- Preferohet që çdo vepër konkurruese të ketë disa nominime.

-Të ketë vlera të larta letrare e të jetë e përputhshme me Rregulloren e manifestimit letrar.

Çmimi letrar „TAHIR DESKU” ka vlerë 500 euro.

Konkurruesit sjellin në zyrat e DKRS-së nga tre (3) ekzemplarë për çdo libër.

Përveç çmimit tradicional, mbahet Ora letrare ku ndahen çmimet për poezinë më të mirë: vendi i parë, i dytë, i tretë dhe çmimi stimulues për krijuesit e rinj.

Ftojme poetët që poezitë e tyre t'i dërgojnë në këtë email: [alban.gashi@rks-gov.net](mailto:alban.gashi@rks-gov.net)

Poetët e poezive që përzgjidhen për konkurrim do njoftohen përmes email-it.

Konkursi mbetet i hapur deri më 1 shtator ndërsa juria shpall rezultatet më 6 shtator, ditën e manifestimit letrar „ORA E TAHIR DESKUT”.

SKENDER MERTURI, drejtor

